



Planuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	30.06.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPEDMS/CK	3828/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.496/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.496/2022 të datës 03.06.2022 të parashtruar nga ankuesi ne adresë

kundër organit të punësimit Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, neni 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.06.2022 njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa me numër A.nr.496/2022 e datës 03.06.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi në datë 03.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 3234/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vlerësim jo të drejt dhe jo transparent për të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit lidhur me pozitën *Specialit i Shkencave të Inxhinierisë Elektronike-Teknologjike/ Zyrtar për Radiokomunikim*, i shpallur nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të

ankuesit në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Ndërsa, Këshilli më datë 14.06.2022 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 3234/2022 të datës 03.06.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Certifikatën e datës 16.10.2013; Certifikatën 2005; Diplomën me Nr. 1140 e ankuesit; Diplomën me Nr. 483 për ankuesin; Certifikatën e datës 08.04.2009; Vërtetimin me Nr. prot:547-5/2022 të datës 01.06.2022; Vërtetimin me Nr. prot:420/2021 i datës 14.07.2021; Certifikatën e datës 08.12.2014; Certifikatën e datës 02.12.2019, 25.08.2016, 15.01.2017; Pasqyrën e llogarisë nga Trusti; Emailin e datës 03.06.2022 nga ankuesi; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 06.06.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 14.06.2022; Njoftimin me Nr.186/2122 i datës 06.05.2022 për kandidatin fitues; Renditja përfundimtare e kandidatëve i datës 06.05.2022; Vlerësimi i aplikantëve nga SIMBNJ; Emailin e datës 06.05.2022 për ankuesin; Kërkesën rreth rezultateve e datës 06.05.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 28.04.2022, 19.04.2022 për ankuesin; Emailin e datës 13.04.2022; Listën e ngushtë e datës 24.03.2022; Njoftimin përmes emailit për ankuesin i datës 25.03.2022; Listën e Aplikantëve; Verifikimin paraprak i datës 23.03.2022; Vendimin me Nr. 067/1/22 i datës 04.04.2022 për themelimin e Komisionit të Pranimit; Konkursin me Nr.Reference RN00008423 i datës 15.02.2022 për grup Specialit të Shkencave të Inxhinierisë të Elektro-Teknologjisë-Zyrtar për Radiokomunikim; Njoftim për konkurs; Kërkesën për punësim e ankuesit dhe Aplikacionin e ankuesit; Aplikacionin e kandidatës Diplomën me Nr. 1301 e kandidatës Kartela e Studentit për Certifikatën 2018 për Certifikatën e datës 16.06.2011 për Certifikatë trajnimi shtator 2019-nëntor 2019; Shkresë për dërgimin e studentit për kryerjen e praktikës Nr.1701/3 e datës 26.03.2010; Marrëveshje e veçantë mbi shërbimin e datës 01.12.2010 për Vërtetim për mbajtjen e punës praktike me Nr.Ark:05-32-25/12 i datës 14.11.2021; Certifikatë nga Raifeisen Bank për periudhën 10.07.2017-31.08.2017; Kontratë Pune me Nr. prot:334/18 e datës 10.09.2018; Letër reference e datës 31.05.2021 për Letër rekomandimi e datës 10.03.2015, 07.02.2019 për Certifikatë e datës 23.04.2020 për Shkresë nga DAAD për Certifikatën nga Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesit është palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë, Kolegji ka gjetur se Autoriteti Rregullativ për Komunikim Elektronike dhe Postare, më datë 15.02.2022 ka publikuar Konkursin me numër reference RN00008423 për grup Specialit të Shkencave të Inxhinierisë të Elektro-Teknologjisë-Zyrtar për Radiokomunikim, me afat të aplikimit nga data 08.03.2022 deri më datë 16.03.2022, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi konkretisht i njëjti ka aplikuar më datë 16.03.2022 me numër e aplikacionit RAN0003422. Ankuesi është përfshirë në listën e ngushtë duke i'u nënshtruar të gjitha fazave të vlerësimit gjegjësisht testit me shkrim, intervistës me gojë dhe vlerësimit të jetëshkrimit. Pas përfundimit të rregullt të procedurës së pranimit për pozitën e lartcekur, Njësia e Burimeve Njerëzore e Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, ka publikuar renditjen përfundimtare të kandidatëve kur rezulton se ankuesi është vlerësuar me gjithsej 71.4 pikë duke u renditur si kandidati i dyti, ndërsa më datë 06.05.2022 është publikuar

Njoftimin me Nr. 186/2/22 për kandidatin fitues sipas të cili kandidatja si kandidatja fituese me gjithsej 83.62 pikë.

është vlerësuar

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon së vlerësimi ka qenë jo i drejtë dhe jo transparent për të gjitha fazat e rekrutimit për këtë pozitë.

Sipas nenit 31 paragrafi 1 dhe 2 Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përcaktohet se: 1.Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore "Këshilli") . 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet" e në kuptim të kësaj bazë ligjore rrjedhë se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër një procesi të pranimit në shërbimin civil, parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës së brendshme të ankesës tek organi që ka shpall procedurën e pranimit. Ndërlidhur me këtë, paragrafi 4 i nenit 31 të Rregullores si me lartë shprehimisht thekson se: Ankesa ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës. Procedura e brendshme e ankesës, vlerësohet së është shteruar nëse: 4.1. kandidati i pakënaqur me rezultatet e verifikimit paraprak ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 15 të kësaj rregulloreje; 4.2. kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje, apo 4.3. kandidati është cenuar drejtpërdrejtë nga aktet me të cilat është zgjidhur ankesa e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 15, sipas paragrafit 6 të nenit.

Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji i Këshillit nga vlerësimi i provave lidhur me këtë procedurë të rekrutimit ka konstatuar se përkundër që me Njoftimin me Nr.186/2/22 të datës 06.05.2022 të Njesisë se Burimeve Njerëzore është dhënë këshillë juridike së pala e pakënaqura ka të drejtë ankese brenda tri (3) ditësh në Komisionin e Pranimit, me asnjë provë nuk dëshmohet së ankuesi të këtë parashtruar ankesë të brendshme, respektivisht meqenëse ankuesi është i pakënaqur me fazën e vlerësimit atëherë në vështrim të bazës ligjore si me lartë ankuesi duhej të ushtronte fillimisht ankesë pranë Komisionit të Pranimit ashtu siç është përcaktuar me nenin 25 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku thuhet seKundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtrojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual, kështu që pas konstatimit së ankuesi ka ushtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa shteruar procedurën e ankesës së brendshme, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton së ankesa A.nr.496/2022 e datës 03.06.2022, e parashtruar nga ankuesi është e papranueshme.

Siç u tha me sipër, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.496/2022

Avdyl BEKTESHI

perlat
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Boratit të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Autoritetin Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.